



Lënda: *Letër drejtuar institucioneve publike nga Grupi i Advokimit të Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale*

I/E Nderuar Zotëri/ Zonjë,

**Ne**, grupi i Advokimit të Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale, nëpërmjet kësaj letre, kërkojmë të përcjellim tek çdo institucion/agjensi publike që punon në fushën e të drejtave të njeriut si dhe tek çdo politikan, mesazhin se personat me aftësi të kufizuara intelektuale mund të vetë-advokojnë në mbrojtje të të drejtave të tyre, nëse mbështeten dhe inkurajohen nga sistemet përreth tyre.

Misioni ynë është të përcjellim zërin e gjithë të rinjve me aftësi të kufizuara intelektuale në mbrojtje të të drejtave tona. **Ne** kërkojmë t'ju bëjmë thirrje institucioneve përgjegjëse për sigurimin e të drejtave që na takojnë, duke bërë të mundur zbatimin e kuadrit ligjor që mbron dhe garanton këto të drejta.

Sipas këtij kuadri, **Ne kemi të drejtë të arsimohemi, të punësohemi, të gëzojmë një jetë me të drejta të barabarta sikurse çdo njeri tjetër**, ndaj detyra e çdo institucioni është të sigurohet që ne të jemi ***pjesë e gjithpërfshirjes në shoqëri, të bëhemi pjesë e vendimarrjeve që lidhen me ne, të jetojmë me dinjitet dhe të japim edhe ne kontributin tonë në shoqëri, brenda mundësive dhe aftësive që kemi.***

**Ne** kërkojmë gjithashtu të na mbështesni që barrierat, të cilat burojnë nga stigma dhe diskriminimi ndaj personave me aftësi të kufizuara, të eliminohen në mënyrë që të mund të jetojmë një jetë, pa përbuzje, pa paragjykim dhe pa përjashtim.

Grupi ynë ju bën thirrje të drejtoni vëmëndjen ndaj nevojave e shqetësime tona, të vlerësoni me përgjegjshmëri e profesionalizëm situatën reale në të cilën ndodhemi e të orientoni përpjekjet për të adresuar problemet me të cilat ne ndeshemi në jetën e përditshme, si dhe të angazhoheni me seriozitet për të garantuar zbatueshmërinë e kuadrit ligjor në mbrojtje të të drejtave tona.

Nënshkruar nga:

Grupi i Advokimit të Personave me Aftësi të Kufizuara Intelektuale.

1. Xhevaire Kokoli.	Tiranë	11. Ledina Gështenja	Librazhd
2. Adrilon Berisha .	Tiranë	12. Fatmir Gështenja	Librazhd
3. Jorida Shijaku.	Tiranë	13. Xhino Valla	Librazhd
4. Armela Beqiraj.	Tiranë	14. Ditmir Shoshi	Shkodër
5. Euxhenio Gostivari	Tiranë	15. Suada Mataj	Shkodër
6. Jonela Loli	Tiranë	16. Senado Zelaj	Shkodër
7. Anastas Beshiri	Tiranë	17. Elsaid Hykaj	Shkodër
8. Ervin Ago	Tiranë	18. Klodian Kodra	Shkodër
9. Doris Koka	Librazhd	19. Erjola Hasa	Shkodër
10. Andi Xharri	Librazhd	20. Shahe Beqa	Shkodër

Shënim: Ngritja e këtij grupi është fryt i bashkëpunimit midis Shoqatës “Ndhmoni Jetën”, Shoqatës”MEDPAK” dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – SOROS, në kuadër të projektit “Të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale”: Vet-Advokues. Përmes kësaj nisme është synuar përgatitja dhe fuqizimi i një grupi të rinjsh me aftësi të kufizuara intelektuale 16-22 vjec, për të zhvilluar në përputhje me kapacitetet e tyre, aftësi për të identifikuar vështirësitë, nevojat dhe interesat e tyre. Këta të rinj kanë zhvilluar një sërë aktivitete, të cilat kanë pasur në fokus promovimin e të drejtave të tyre, luftën ndaj stigmës dhe diskriminimit për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara intelektuale, ngritjen e një rrjeti shërbimesh në mbështetje të tyre dhe mbi të gjitha krijimin e hapësirave ku këta të rinj kanë mundur të tregojnë aftësitë dhe potencialet që ata mbartin.

Profesionistët e përfshirë në këtë nisëm kanë ndihmuar të rinjtë vet-advokues për të hartuar këtë letër me gjuhën zyrtare.